

KOSTANDIN  
DHAMO



POEZI

Përshëndetje

8SH-1  
Sh. 18

891.983-1<sub>5</sub>

KOSTANDIN DHAMO

# PËRSHËNDETJE!

Poezi

~~53490~~

12.150

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## FLLAD

Ne u nisëm hapsirave të largëta.  
Zbardhin re të lehta rreth diellit,  
Tek ndaheshim diellin ta këpus më erdhi  
Që njerëzve t'ua dhuroj si një trëndafil  
të bardhë.

Lulet flladisin pranverën mbi pemë  
Dhe shkunden nga degët si flutura të trëmbura  
Të gjithë e ndejmë në shpirt pranverën,  
Të gjithë e shprehim me fjalë të ëmbla!

Fërgëllojnë ngjyrat në kaltërsi  
Në zemër lindin këngë rinore,  
Tundet një degë e hollë si një baketë  
Që tempon i mban melodisë pranverore.



S'do ndalim kurrë diku. Po gjithmonë  
Veç do të rendim shtigjeve pa fund.  
Ja, një qytezë vullnetarësh zbardh  
Zbardh edhe një, e para diku humb. . .

Ne u nisëm hapsirave të largëta  
Shami aksionesh era shkumëzon dhe derdh  
Nga buzëqeshjet tona të çiltra, të ëmbla  
Dhe dielli duket se rend midis nesh.

## RRUGA E PYLLIT

Sa e lashtë kjo ngjitja e malësorëve drejt pyllit  
Sa e re kjo ngjitja e malësorëve drejt pyllit. . .

Ata gjithmonë u ngjitën atje  
Ku ndihet veç pëshpërime e përjetshme e tij  
Fëshfërime e pemëve dhe gurgullima e ujërave  
Gjithmonë të ruajtura nga pushka hakmarrëse  
e gjaksit

Që ngrihej midis shkurresh  
Dhe fuste në shënjestër diellin e pasditës.

Ata sot po ngjiten atje  
Me shami të purpurta në kokë si copra  
peizazhesh të mugëta.  
Sot po ngjiten të gjithë bashkë  
Nëpër shkrepat e bardhë, mes shkurreve, buzë  
ujvareve

Dhe ndihen mes hijeve dhe reflekseve të tyre  
krismat e pushkëve  
të vetmuara.

Pam-pam, pam-pam, pam-pam...  
Jehojnë përsëri të mjegullta nëpër qiellzat e  
honeve dhe fantazive  
Dhe shuhen përgjithmonë larg  
Pam-pam, pam-pam, pam-pam...

Një daulle gjëmon në fshat!

Shtylla të larta elektrike ata do të presin  
Pylli i dendur mbi mal do të shpërndahet  
nëpër atdhe.  
Ku rrahin vallë tashti listelat e daulles,  
Mbi membranat e saj apo horizonteve?



## TELAT PO KAPTOJNË KODRA EDHE MALE

Telat po kaptojnë kodra edhe male  
Llambat po ndriçojnë tokën e malësisë  
Ti malësor që hidhesh i shkathët në valle  
Dridhi këta tela si të çiftelisë...

Ujrat po rrëshqasin mbi hidrocentrale  
Të qeshur, të shpejtë, tërë shkumë e zhurmë  
Me shkëlqim ylberesh do të hyjnë në valle  
Diellin si turbinë do shtjellin në fund.

Ujrat shamibardha, ujrat shamikaltra  
Vijnë që nga mali gjithë vezullime  
Ç'u dridhen, ç'u ndrisin porsi mijëra llamba  
Vijnë të na çelin dritën komuniste.

Do të thuren këngë, do të hidhen valle  
Për dritat e reja valle edhe këngë

Siç ka qenë gjithmonë në Malësinë e Madhe  
Këngë edhe valle, valle edhe këngë...

Telat po kaptojnë kodra edhe male  
Llambat po ndriçojnë tokën e Malësisë  
Ti malësor që hidhesh i shpejtë në valle  
Dridhi këto tela si të çiftelisë!



## SHKRIMET E SHOKËVE

Verës punova në gazetë...  
Zarfa të bardhë më vinin  
Me shkrimet e shokëve.  
Shokët ishin nisur në aksione  
Dhe vendlindjeve gjithmonë të bukura,  
Qyteteve dhe fshatrave të largëta.

Shokët ishin nisur larg  
Vinin vjersha të bukura  
Vjersha të zakonshme  
Për dashurinë e re të vajzave të reja,  
Për korrjet e dallgëve të arta të arave.  
Motive nga këngët e sinqerta populllore...

Unë hapja dritaren dhe lëvizja  
Poshtë, lart  
Diellin, flladin dhe hapsirat e kaltra  
Sikur m'i dërgonin shokët nga larg...

## LEGJENDA E PËRKRENARES SË SKËNDERBEUT

*(sipas motiveve popullore)*

**Populli që flet gjuhën e vet  
Ka edhe legjendat e veta.**

Lart në malin Tumenisht<sup>1)</sup>  
Skënderbeu bashkë me trimat  
Ishin ulur hanin bukë  
Dhe mbi brrucat leshatore  
U hidh' hëna rrezë të verdha  
Ndaj dhe dukeshin si luanë  
Që preheshin mbledhur bashkë.  
Kur dëgjon bubullima,  
Bubullimë e zhurmë përtej  
Që prej vendit me vrap ngrihet:

---

1) Tumenishti — mali ku Skënderbeu i zinte pritë ushtrisë turke dhe nga ku e sulmonte pastaj në befasi.

«Dilni shihni ju, o trima  
Ç'ështëë kjo zhurmë që po ndihet  
Në ështëë qielli që gjëmon  
Të më ktheheni këtu prapë.  
Në janë turqit që gjëmojnë  
Ktheni një të më thërrasë».  
Dolën trimat edhe panë  
Se nuk ishte gjëmë e qiellit.  
Dolën trimat edhe panë,  
Nëpër flakën e pishtarit  
Pararojën e turk armikut  
Me flamujtë të shpalosur,  
Me flamujtë gjak të kuq  
Që lëpinin errësirën  
Porsi gjuhë të përgjakura.  
Dolën trimat edhe panë  
Tendat larg, radhë-radhë  
Që përngjanin në errësirë  
Porsi gurë të zbehtë varri.

Lart në malin Tumenisht  
Erdhën trimat edhe thanë:  
— E zbuluan turqit pritën  
Dhe drejt nesh tani po vijnë...  
Nis të flasë trimi i dytë:  
— Nuk po vijnë po kanë ardhur  
Dhe po presin nat'n e vonë.



Nis të flasë trimi i tretë:  
— Nuk po presin nat'n e vonë  
Por kërkojnë shteg të ngjiten!  
Është ngritur Skënderbeu  
E ka marrë frymë thellë  
Trimave ç'u është dukur  
Se dy male janë çarë  
Dhe rrethimi është hapur. . .  
Ka marrë rrugën nëpër shesh  
Hapngadaltë e i menduar  
E së fundi shkon mbështetet  
Tek një pemë e vetmuar.  
Rri i heshtur e dëgjon  
Zhurmë këmbësh që vrapojnë;  
Kali s'rend ashtu, mendon  
As njeriu s'rend ashtu,  
Ndaj kujton se Tumenishti  
Është mal me shumë dhi  
Dhia trembet e largohet  
Kur shikon se vjen njeri.  
Dhe papritur që të gjithë  
Kanë parë dhitë e egra  
Duke rendur me rrëmujë  
Brinjave të trembura.  
I kanë ndjekur dhitë pas  
Mbi shkëmbinj e majë më majë.  
Kthehen dhitë e kthehen trimat  
Rrugë pa rrugë e qafë më qafë.

Turren dhitë mbi një shkëmb  
Dhe e ndalin vrap'n e shpejtë.  
Mbi një shkrep trimat i presin  
Si shqiponjat mbi foletë.  
Presin trimat, s'u pret koha  
Mali natën do kaptuar  
Malit maja i cik retë.  
Ja, dy dhi ndahen nga tufa  
Zgjasin kokat mbi rrëpira  
Pastaj kthehen prap në tufë  
Edhe rendin shpejt përpara.  
E kuptoi Skënderbeu  
E kuptuan edhe trimat  
Dhitë turqit kanë parë  
Ndaj nga është shtegu i lirë  
Janë kthyer, kanë rendur.  
Që të gjithë u shkuan pas  
Duke zbritur shkëmb më shkëmb  
Dhe përpara kanë parë  
Një përrua të rrëmbyer  
Të rrethuar me gëmusha.  
Rend një trim e kap një dhi  
E i lidhin mu në brirë  
Një pishtar të gjatë, të ndezur.  
E lëshojnë e dhia rend  
Bashkë me shoqet shpatit drejt  
Ku fillon qafa e malit  
Ku merr rruga të përpjetë.



Nga bedenat, mbi kala  
Panë trimat një pishtar  
Një pishtar që rend e skuq,  
Një pishtar q'i lajmëron  
Që të hidhen bashkë në sulm.

Nga rrethimi të shpëtuar  
Kur janë mbledhur gjithë bashkë  
Kanë pyetur trimërinë:  
— O trimëri, trimëria jonë  
Vallë ty zemra sa të bën?  
— Ajo rreh për nëntë zemra  
Me nëntqind ajo lufton.  
Pastaj pyetën edhe shpatën:  
— O ti shpatë, shpata jonë  
Vallë ty zemra sa të bën?  
— Ajo rreh për nëntë zemra  
Me nëntqind ajo lufton.  
Pyetën pastaj dhe kalin:  
— O ti kalë, kali ynë  
Vallë ty zemra sa të bën?  
— Ajo rreh për nëntë zemra  
Me nëntqind ajo lufton.  
Ç'u lëshuan si petrira

Si petrirat mbi lumbardha  
U zbardh fusha tejendanë  
Si me brymë nga shkumë e kuajve.



Ca të vrarë, ca të plagosur  
Nënë shpatë gjithë i shkuan  
Nënë shpatën që shkëlqente  
E tërë fushën llamburiste.  
Ç'u mbush qielli me yje  
Si me plagë nga shigjetat.  
Ç'u bën ura përmbi ura  
Nga të thyerat shigjeta.  
Ç'u bën kryqe mbi të vrarët  
Nga të ngulurat shigjeta  
Porsi kryqe përmbi varre...

## NË STUDIO E SKULPTORIT

Në studion e lartë, të hirtë ku hyn veç drita  
e ftohtë e veriut  
Erdhi një nënë dëshmori dhe e heshtur qëndroi në  
këmbë.

Skulptori gdhendte ngadalë më tej  
Buzëqeshjen e kristaltë të një fëmije në mermer.

Portretin e dëshmorit skulptori e çoi në ekspozitë  
Mbajti dhe një në studio t'ja jepte nënës dhuratë  
Ajo nxori nga shalli lule dhe i vuri në një vazo  
E heshtur, me buzëqeshjen e ndrojtur, të lehtë  
Si një lule që e vuri me të tjerat në vazo.

Nën shaminë e bardhë i rrodhën lot të heshtur  
Si ujët e kristaltë që rrjedh nën dëborën e pranverës  
Ajo u përkul ngadalë mbi djalin e saj dëshmor  
Dhe mbi ballë u duk sikur i la një trëndafil të bardhë.

## NË KINEMA

*(Motivet e kishës)*

Vajza dhe djem ngjisim të lehtë shkallët  
Dhe hymë në sallën e lartë të kinemasë.  
Në vend të organos së ngjirur, melankolike,  
Kanë vënë një megafon  
Dhe në vend të altarit hyjnor  
Ekranin e bardhë kanë vënë.  
U hap kinemaja e re  
Përballë ditëve të reja...

12 150

LIBRARI E SHKOLLË  
SHKOLLËS NË  
~~53150~~



«OBJEKT TURISTIK»

Buzë rrugës ngrihet kisha mbi kolonat e  
zbehta si kocka të brejtura.

Dhe xhamat e purpurt në dritare si të  
ngjyrosura nga perëndimet.

Asnjëri s'ndal më pranë saj,  
Përveç turistëve të huaj që vijnë me pulmanë  
Për të parë arkitekturën e saj të zyrtë  
Dhe afresket e ciflosur, të lashtë.

## ROSAT E EGRA

Mes yjeve tufa e imët e rosave të argjendta  
Si kashta e kumtrit shquhet tek fluturon  
Erdhën në vendlindje, a vijnë nga vendlindje  
Erdhën në vendlindje, a vijnë nga vendlindje  
konstelacion.

Ejani rosa në zooparkun e qytetit tonë  
Dhe mbi basenat e kaltërt uluni t'argjëndta  
Drejt kënetave ku po shtegtoni  
Tani krihen arat e blerta...

Uluni rosa në zooparkun e qytetit tonë  
Do të vijnë t'ju shohin njerëzit mbi ujërat  
e kaltra  
Vjeshtës, në sezonin e tij të mbylljes  
Prapë mund të fluturoni vendeve të ngrohta.

## DIALOG VALLEJE

Përreth valles mblidhen djem  
Hidhu dhe ti, hidhu në valle!  
Vajza e re e shpejtë po kërcen  
Dhe i rreh daullja gjëmëmadhe.

Shaminë era ja flladit  
Dhe ja tund të bardhat mëngë  
Si një thëllëzë e brishtë mali  
Që shkund dëborë nga krahët.

Tallazi i valles shkumëzon  
Gjithkush kërcen i lumtur  
Shami e njërit lule derdh  
E tjetrit purpur, purpur...



Hyr dhe ti, kërce i shpejtë  
Me vajzën. . . Hajt, gëzuar  
Ç'i ndrisin sytë nën flokt' e zes  
Si yj nën shelgun flokëlëshuar.

Rrotullohet, qesh e bukur  
Merre në shtëpi si nuse  
Vajzë e bardhë në shtëpi të bardhë  
Belkëputur si një lule.

Vajzën në shtëpi do marr  
Dhe me mall do e mbaj krahve  
Ç'do më shkrijë porsì mjegulla  
Që humbet e heshtur qiejve.

Hyr, pra hyr, kërce i shpejtë  
Djalë i ri, vajzë e re  
Hyr, kërce dhe si shami  
Shkund nga qielli ndonjë re!

## PIKTORI

Një piktor qëndroi pas parmakëve, tek një lulishte  
verore,  
Nën një afishe të bardhë që lajmëronte një garë  
çiklistësh  
Dhe ngriti i menduar penelin e hollë lart  
Sikur desh ta ngjyrote me muzgje, dritë,  
buzëqeshje;

Breza të artë drurësh vagëllojnë mes mjegullave si  
muzgje,  
Grumbuj ndërtesash të rrethuara si me shami  
nga rrugët,  
Punëtorë që kthehen nga puna dhe ecin grupe-  
grupe,  
Të rinj që dalin plot hov nga një seancë filmi,  
Ti që buzëqesh, ata që u takuan, ata që rendin,  
Qielli i ulët dhe njëkohësisht aq i lartë  
Dhe hëna e artë që doli dhe u duk  
Si një gjethe vjeshte që do t'i binte dikujt mbi sup...

## NË THETH

Aromë trëndafilash të egër dhe këngë popullore,  
Vorbulla të kaltra ere mes grykave të thella.  
Këndojnë vetë malësorët, këndojnë dhe radiot  
këngët e tyre.

Erdha në Theth tani në verë  
Dhe hëna rritet akoma mbi malet e bardha  
Si një ortek vezullues që poshtë do të shkasë  
Dhe vetëtimat shquhen parreshtur të shpejta,  
Si dhi të egra që hidhen shkrepave të lartë...

Arrita në Theth në muzg.  
Nga mali derdhen ujvaret dhe detet e bardha  
Dhe në udhë të përshëndesin të gjithë malësorët  
dhe malësoret e reja  
Tek zbresin nga tarracat dhe kullotat alpine  
erëlehta.



Gurgullima flladitëse, tringëllima zilesh, fërgë-  
llima yjesh

Mos vallë kam qenë gjithmonë

Mes këtyre maleve dhe këtij peizazhi baritor?

## MELODIA E JETËS

Për herë të parë u përkul mbi çifteli  
Kur gjaksi i tmerrshëm i vrau babanë.  
Rrezet e diellit ju derdhën të kuqe mbi sy  
Sikur gjaksi me plumbin e pushkës së tij  
Dhe diellin e lartë të kishte gjakosur.

Ishte melodia e lashtë e jetës  
Që mund të rridhte me një këngë të gëzuar  
Siç mund të rridhte dhe me një këngë të trishtë.  
Ishte melodia që e dëgjonte në ditët e vdekjeve  
Dhe në ditët nervoze të dasmave.

Ishte melodia e këngës së plasaritjeve të tokës  
Që dukeshin si një mozaik i urisë dhe i mjerimit,  
Apo si një tatuazh i thellë, i dhimbshëm  
Mbi trupin e saj të nxirë, të dobët.

Ishte melodia e këngës së tufave të bardha të  
deleve  
Që vinin nga jugu plot tinguj të dridhshëm  
këmborësh  
Që mbulonin kodrën e murme ngadalë, ngadalë  
Siç e mbulon dimrit dhe dëborë e parë.

Ishte melodia e këngës së dritave që lulëzuan  
sonde në fshat  
Që ulën mbi shtyllat aureola të ndritshme  
Si kurora lulesh mbi lapidare  
Dhe çdo shtyllë kish pse të quhej një lapidar;

I megjullon malësori telat me dorën e rëndë  
Nën kryet krenare të ndriçuarë përgjysmë  
Si kreshta e një mali nga rrezet e diellit  
Që rrjedhin mes resh të pahapura krejt.

Ishte melodia e lashtë e jetës. . .  
Ishte melodia më e re e jetës.



## YLBERI

Një vepër e madhe industriale shquhet  
në horizontin e bardhë,  
Një vepër në mbarim.  
Mbi të  
Si fjongo inaugurimi  
Doli ylberi, ylberi i shumëgjyreshëm.



## DIELLA

Vjet në pranverë Diella i gëzoi prindërit shumë  
Shkoi në qytet dhe këndoi disa këngë të krahinës  
së tyre,  
Por në vjeshtë i hidhëroi shumë  
Iku përsëri në qytet me një djalë që dashurohej  
Dhe pastaj ata dëgjuan se punonin së bashku diku  
në një kantier.

Dhe Diella erdhi përsëri në fshat me të dashurin e saj.  
Zbriti nëpër rrugët e fëminisë dhe hyri në fshat  
— Erdhi Diella, — thirrën ca fëmijë dhe rendën  
shtëpive.

Ja, lëvizën disa perde  
Dhe nga shtëpia e shoqes së Diellës dolën të gjithë.  
Nëna e saj vuri duart në ije dhe qeshi.  
Qeshi dhe i ati i saj, ndërsa ajo vetë u përlot.  
I ati kish vënë dorën pas veshit dhe qeshte



(Kështu e vënë dorën malësorët gjithmonë kur  
këndojnë

Dhe ai e vuri dorën atje edhe tani)

Dhe qeshnin. . .

Dhe Diella e veshur me një bluzë të bardhë

Kishte një nur të lehtë nusërie në fytyrë.

Ja, dolën dhe fqinjët e tjerë dhe qeshën

Qeshnin të gjithë lehtë sikur kishin dalë të shihnin  
një pemë të sapolulëzuar.

Doli dhe nëna e saj, babai i saj, vëllezërit e saj,

Fqinjët vinin pas

Dhe i ati i Diellës i bërtiti për diçka nënës.

Plaku desh të merrej me diçka atë çast. S'duronte  
dot. . .

Po vetëm kaq.

Dhe i dashuri i Diellës u hutua fare

Qeshnin-qeshnin-qeshnin. . .

Dhe Diella shihte rrotull dhe dëgjonte të qeshurat

I dukej sikur zbriste nga skena ku këndoi këngët  
e krahinës së tyre. . .

## NJË VAJZË

Porsi një shkurre e purpurt jargavani  
Muzgu u var mes pallateve  
Shiu i hollë nën qiellin e bardhë  
Sikur shkundej nga lulet e pemëve.

Unë shkruaj vjersha  
(O, s'kam shumë që shkruaj. . .)  
Sytë më janë zbehur pak  
Dhe dukem gjithmonë e menduar.

Në pallatin e bardhë të kulturës  
Ngjiten djem dhe vajza të reja  
Lart në një sallë do flasin  
Për një libër të bukur me vjersha.

Flokët e verdhë m'u qullën  
Dhe prapa i derdh, i shkund,  
Ca djem më shikojnë të heshtur,  
E heshtur i shoh edhe unë.

Pallatit të bardhë ngjiten  
Të lehtë djem edhe vajza,  
Lukse flekset e blertë pas xhamave  
Si palma të harlisura serrave të kaltra.

Kam shkruar diçka për aksionet,  
Diçka për dashurinë kam shkruar,  
Veç ndihem (s'do mend!) pak e ndrojtur  
Dhe akoma gjëkund s'i kam çuar.

Nuk njoh një vajzë që shkruan,  
Një djalë që shkruan nuk njoh,  
Bluza të bardha, të kaltra  
Akoma njeri unë nuk njoh...

Do ngjitem lart e lehtë  
Me shokë të njihem në sallë  
Jashtë neonet këtë çast  
Shpalosën dritën e bardhë.



## HIDROCENTRALI «MAO CE DUN»

Ja shtëpia e bardhë, lart mbi kodër  
Hëna e portokalltë, e nderur mbi gardh si një bluzë  
e vogël fëmije.

Ai kthehej nga hidrocentrali.

Hapte derën e gardhit dhe kthehej pas e shihte  
Ulej pranë vatrës dhe s'ndihej mirë tek shihte  
llambën lart.

Shumë gjëra pas punës i dukeshin të çuditshme  
Sikur gjithmonë atyre diçka s'u kishte parë  
Sikur kish kohë që s'i shihte dhe s'mirrej me to.

As gruan s'e kuptonte më si më parë  
Duhej të kish pushkën e vjetër pranë, apo mashën  
e vatrës...  
Diçka të vjetër, qoftë edhe kot, ndryshe s'e kuptonte

Dhe të mos shihte buqetat e dritës së hidrocentra-  
lit larg

Dhe as të dëgjonte kumbimin e tij të thellë.

Gruaja kish akoma diçka të vjetër në sjelljen e saj.

Kishte edhe ai. Herë-herë zbriste poshtë në grazhd,

Apo shihte pemët e heshtura përreth.

Dikur ish marrë vetëm me pemët dhe delet

Dhe tani i dukej gjithmonë se andej kishte harruar  
diçka.

... Një kumbim i thellë, buqeta të bardha dritash larg

Gruan vërtet s'e paskej kuptuar

Nesër do të shkonin bashkë në hidrocentral...

## KISHA ME DRITË ELEKTRIKE

— *meditime poetike* —

1.

Prifti i kërrusur me shpirt të ndrydhur, të ftohtë  
Humbet tutje në muzgun e heshtur të mbrëmjes.  
Hieja e tij të nderet mbi sy si një mjegull  
Dhe shket pastaj e errët kudo që sheh  
Duke u tundur si një fjongo zie  
Mbi dyert e botës së vjetër që ngadalë po vdes. . .

2.

Kubeja e kishës me tjegulla rrotull  
Si tonsura e një prifti, rrethuar me flokë,  
Sikur lëkundet i duket tek e sheh së largu  
Mes mirazhit të nxehtë të mendjes së tij të  
turbullt.

Në kishën që e bënë vatër kulture  
Të rinjtë këndojnë këngë të vrullshme, të zjarrta.



Lart yjet fërgëllojnë si tingujt e këngëve  
Të rinjtë këndojnë, këngët gurgullojnë shtigjeve.

Në jetën e tij prifti kish dëgjuar shumë këngë;  
Këngët korale të kishës, këngë të tjera të  
ndryshme;

Po kurrë s'i sollën mendime kaq të trishta  
Dhe një varg kujtimesh kaq të gjatë  
Sa i sollën këto këngët e reja  
Këtë natë.

3.

Kujtoi prifti;  
Në fillim  
Pranë kishës kaloi rruga e drejtë, e gjatë  
Pastaj  
Shtyllat e larta elektrike  
Të ngritura anëve të saj.  
I kishte parë prifti  
Maqinat e rënda që gulçonin...  
Sa zhurmë bënë maqinat!  
Sa pluhur ngrinin maqinat!  
Vinte reja e tyre te korridoret, në kishë  
Dhe ajrit atje ja prishte virgjërinë.

Jo kaq pluhur pranë kishës!  
Ja kaq pluhur pranë kishës!  
Qetësi...

Pranë kishës prifti kërkonte qetësi,  
Pranë kishës kërkonte të mbetej  
Vetëm rruga e mugët me baltë,  
Vetëm rruga e rrudhosur  
Nga rrota e qerres së lashtë).

4.

Kujtoi prifti,  
Pastaj  
Maqinat me të rinj kishte parë —  
Shumë maqina me të rinj  
Që vinin, përhapeshin kudo nëpër krahinë,  
Që vinin punonin kudo nëpër krahinë.

Ah, këta të rinjtë!  
Tepër të hedhur, tepër të qeshur, tepër të  
shkujdesur.  
Kishin në mës tyre dhe vajza të reja të malësisë  
Që prishnin fejesat e tmerrshme  
Të lidhura edhe nga priftërinjtë.

Ah, këta të rinjtë  
Netëve mblidheshin nëpër fshatarë  
Dhe flisnin për fenë, për botën e vjetër,  
Për punët, për të ngrënit, për çdo gjë...  
Që fshatarët përpiqeshin t'i kryenin gjithmonë  
si të parët.

Gjithmonë njësoj sikur kryenin rite të lashta  
Duke e kthyer jetën e tyre  
Në një jetë të përgjumur të ftohtë rituale.

Flisnin dhe pyesnin për folklorin —  
Për artin popullor që është gjithmonë i ri,  
Për artin popullor që është gjithmonë i lashtë,  
Me këngët dhe vallet e bukura të tij.

Ah, këta të rinjtë  
E mbushnin gjithë vendin  
Këngë — këngë — këngë...  
Mes këngëve diçka vdiste,  
Mes këngëve diçka lindte...

(Përse të vinin njerëz të tjerë nëpër krahinë,  
Përse t'i turbullonin njerëzit e qetë, të urtë,  
Përse kaq lëvizje, kaq këngë, kaq zhurmë?!)

Ah, këta të rinjtë,  
Tepër të hedhur, tepër të qeshur!  
Kishte frikë prifti  
Nga shkujdesja e tyre  
Bile  
Edhe nga buzëqeshja e tyre.



5.

Ah, kjo rruga e shtruar, e drejtë,  
Si një gisht tregues tepër i gjatë  
E futi kishën në shënjestrën e revolucionit  
Nga ku drejtohen mijëra sy  
Nga ku drejtohen mijëra mendje.

6.

Kujtoi prifti:  
Besimtarët në kishë rralloheshin shumë.  
Ishte munduar ai  
T'i mbante pranë besimtarët e rrallë,  
Por besimtarët rralloheshin,  
Vetëm rralloheshin...

Kujtoi ai  
Se si dërsinte dikur në meshën e gjatë  
Me sy të skuqur si xhamet e kishës  
T'u sugjestiononte njerëzve figurën e zotit,  
Figurën hyjnore me mjekër të bardhë  
Që njerëzit të ngroheshin, të mbeteshin pranë  
Por njerëzit hynin të ftohtë  
Dhe dilnin të ftohtë!

(Ka shumë këngë pranë kishës  
Ka shumë lëvizje pranë kishës

Kisha duhet të jetë pranë njerëzve të urtë,  
të qetë

Mes vendeve të larta, të thella  
Pranë zhurmëve të brishta qetësuese të natyrës  
Larg shqetësimeve, larg këngëve, larg buzë-  
qeshjeve,  
Larg periferive industriale, larg inaugurimeve...

Po ku ishte ky vend i lartë, i thellë  
Po ku ishin këta njerëz të urtë, të qetë?)

7.

Kujtoi prifti:  
U shua së fundi arkitektura ornamentale e  
kishave

Dhe ndërtesat e tyre u bënë  
Vatra kulture, kinema, restorante...  
(Dhe gjithshka tjetër që mund të bëhet një  
ndërtesë.)

Kambanoret  
Disa u bënë kulla vrojtimi zjarrfiksash  
Disa u prishën fare  
Kurse disa mbetën si gishta të mpirë drejt qiellit  
gri

Pa tinguj, pa jehona,  
Si gjymtyrë të rudimentuara nga koha.

Dhe priftin e larguan nga vetja e tij  
Tani në mbrëmjen e jetës së tij.

8.

Në vesh i rrihnin këngët kumbuese të të rinjve,  
Dhe i kujtonin ikjen e tij tutje nëpër muzg.  
Prifti ngriti lart mëngët e gjera të veladonit  
Mbi hijen e tij të zezë si një kryq i zi  
Pa në kupolën e qiellit hënën e plotë  
Përçark me rreth të ndritshëm  
Si koka e një shenjti me aureolë.

Por s'mundi ta ngushëllonte veten aspak  
Tek pa mbi krye telat e nderë elektrike  
Që ja fshikën vështrimin si me kamzhik.

9.

Telat zgjaten drejt fshatit  
Tendosur mbi shtyllat e larta elektrike.  
Telat do të ndalen dhe në kishë, mbi çati  
Dhe në vend të kryqit të vjetër, të zi  
Do të duket një shtyllë e vogël e hekurt.

Kisha me drita elektrike  
Kisha vatër kulture



Në vend të dritës së verdhë, të sëmurë të qiriut,  
Do ndrisë dnita e bardhë, e fortë elektrike.

Netëve

Të rinjtë do të mblidhen aty  
Të flasin kundër fesë  
Në shtëpinë e vjetër të fesë,  
Të shohin një film shqiptar  
Që shfaq një dashuri të re,  
Që shfaq një jetë të re.

10.

I rrihte në vesh kënga kumbuese e të rinjve  
Kudo ndihet ajo, kudo buçet ajo  
Edhe në malësi, në kulla, në kisha... Kudo.

## O, PORTOKALLE, PORTOKALLE

O, portokalle, portokalle...  
Qeshe ëmbël tek i pe të artë,  
Erdhe t'i mbledhësh në shporta  
Flladit nga deti agimi i bardhë.

Pemët përkulin përparset plot  
Kokrra të arta, të ftohta  
Netëve të bukura, të kthjellta të vjeshtës  
Mos hëna i ngjyrosi ndoshta?

Këtu mes fëshfëritjes sikur u fshehën  
Aromat dhe ngjyrat e vjeshtës  
Këput, këput dhe mallëngjehesh lehtë,  
Mes fëshfëritjes frutat e vjeshtës.

Ndalesh një çast, mbështetesh lehtë  
U mbushën gjithato shporta...

Ç'e kini këtë hap të butë  
Dhe këta sy, moj motra!

Ja, erdh t'i marrë një kamionçinë  
(«përherë çapkën shoferi».)  
Mes buzëve ka një buzëqeshje  
Si copë të artë portokalli.

Nis e këndon diçka përçart  
Se ç'thotë për malin... lulet  
Dhe s'dihet ç'sheh tek vërtitet  
Vajzat apo portokallet.

O, portokalle, o portokalle...  
Mëngjezeve të bardha këputen, nisen  
Sikur ndahen me vëllezër të vegjël,  
Vajzat e reja mallëngjehen.



## POPULLORE

Lule të bukura, vajza të bukura  
Ja ku doli një në portë  
Pas saj doli edhe plaka  
Me një qen (a u tërboftë!)

Nuk shkoj dot t'i flas te porta  
Mbaje qenin, plakë, mbaje  
Shikoj vajzën, më shikon  
Ikë plakë, se më çmende! . .

## SHËNIME NGA XHIRIMI I NJË FILMI

Në mugëtirën e dhomës së Migjenit prozhektorët  
lindën të bardhë.  
Ja orenditë dhe sendet nën heshtjen e rëndë monu-  
mentale.  
Unë pashë përreth ngadalë  
Sikur diku, patjetër do ta takoja Migjenin.

Ja dhe dritarja e kaltërt, qyteti, bjeshkët...  
Qyteti me shtëpitë e ulëta që zverdhej dikur netëve  
i hënëzuar  
Si një dekor i heshtur theatri  
Që braktisej pas dramës së përditshme të jetës.

Migjeni hynte në dhomë dhe mbështetej i menduar  
në derë  
Përreth i kumbonin akoma zhurmat dhe thirrjet  
e ditës

Dhe i dukej sikur ish përkulur rëndë mbi mugëtirën  
e telave të dridhshëm të një harpe.

Hapte dritaren dhe shihte përsëri nëpër natë,  
Mbi qytet vetëm hëna e ngecur si një flutur mes  
merimangës së degëve të zhveshura të dimrit.  
Dhe larg si një relief i lashtë i urisë  
Bjeshkët me hone të thella dhe rremba shkëmborë  
të bardhë.

Migjeni hynte në dhomë dhe prej frymëzimit të tij  
të dhimbshëm  
Ulej të shkruante me një ndjenjë të çuditshme  
Sikur kishte mbledhur lule të dirsura diku  
nëpër natë...

Migjeni kishte diçka mëngjezore në shikimin e tij  
Kishte diçka nga mëngjezi i ditëve tona në shpresën  
e tij, në rimat e poezisë së tij.  
Dhe sot, kur mbi bjeshkë ndizen dritat e reja  
Kujtojmë një çast në heshtje buzëqeshjen e bukur, të  
largët të poetit  
Dhe kur takojmë rrugëve djem dhe vajza të reja  
Prapë buzëqeshjen e poetit na kujton buzëqeshja  
e tyre  
Dhe gëzohemi që Migjeni është kaq shumë pranë;  
midis jush, midis nesh.  
Shohim diellin lart. Dielli kudo na ndjek  
Si buzëqeshja e gjatë përshëndetëse e poetit...



## SHOTE GALICA

Të gjithë trima gjokserreshkur  
Burra të rëndë e ballëlart  
Ty të kanë vënë në krye  
Grua trime me nagantë.

Nëpër shtigje buzë qiellit  
Ti me çetën trokon larg  
Nënat sokëllijnë fshatrave  
Ndër oborre mpikset gjak.

Mes shtëpive, në qytet  
Të rrethojnë shpesh xhandarë  
Netëve ti zbret dhe bën  
Mbi katilët atentat.

Të rrethojnë, të plagosin,  
Shëmben shpitë kosovare,  
Lart në dhoma ti e mbyllur  
Në bedenë i kthen dritaret.

Pas të ndjekin nëpër male  
Ti me çetën trokon larg,  
Si një kockë e brejtur hëna  
Zverdh e hollë përmbi mal.

Luftë në mal, prehje në mal  
Shi, erë dhe shtegëtime,  
Shkrepëtijnë potkojtë dhe qiejt  
Shkrepëtijnë pushkët trime.

Qave burrin, qave trima,  
Lidhe plagë, të lidhën plagë,  
Sa e rëndë jetë e malit  
Moj komitja me nagant.

Gjithë ndjenjat vajzërore  
Diku thellë i ndrydhe ti  
Në një nyje që rëndon  
Si një medalion kujtimi.

Përmbi kalë i ndjeve vitet  
Në mes luftërash me rrebesh.  
Kali yt trokon, trokon  
Jelen zbardh mes jele resh.

Burrat ngjiten, tërë fshatrat  
Lënë shtëpitë; luftojnë në male  
Pushkë e nxehtë kudo vret  
O, Kosovë, o kosovare!..



## NË BALLKONIN E PRITJES

Ti je përkulur rëndë mbi ballkon  
Dhe pret të fejuarin tënd.  
Kështu e pret ti çdo ditë në muzg,  
Përkulesh mbi ballkon  
Dhe supeve derdh natën e dridhshme të  
flokëve...

(Ti e mbarove gjimnazin  
Dhe së fundi u fejove me dikë,  
Por s'është mirë të dilni çdo mbrëmje  
së bashku.  
Dhe në shtëpi... shtëpia është e madhe,  
Mund të takohesh dhe të bisedosh me të).

Kështu të thonë prindërit...  
Dhe ti pret, pret  
Dhe ai nuk lë kurrë për ardhjen e tij një orë  
të saktë,

Sepse fundja ti e pret në shtëpi.  
Por ti del muzgjeve dhe rëndon mbi ballkon  
Tani e fejuar  
Më shumë se më parë të ardhmen mendon.

## MBRËMË

Tek ktheheshim bashkë të lumtur në orët e vona  
të mbrëmjes  
Pamë djemtë e kinemave me reklama ndër duar  
Ti pyete:

ç'po afishojnë vallë?

Unë thashë:

Ndoshta afishojnë pranverën...



## ATENTATORI

Vasil Laçit

Perandori u shfaq në Tiranë pas sulmit, pas ushtrisë  
Porsi emblemat, mbishkrimet, afishet e pushtimit.  
Në qendër të qytetit kishin dalë njerëz  
Kishin dalë priftërinj me rrobe të zeza, të zeza,  
Sikur gjithmonë u shihje veç hijet e shqetësuar,  
të holla.

Kortezhi perandorak afrohej ngadalë.  
Një tytë revolveri nën një buqetë priste e ftohtë.  
Në ajrin mbytës fjalët kumbonin si mbi një  
membranë  
Si metastaza kanceri vetëtimat fërgëllonin larg.

(Atentatori ish një punëtor i thjeshtë  
Një djalosh i ri që shkruante dhe vjersha  
Kish ngjitur shpesh shkallët e redaksive

Shkallët me parmakë të bardhë si fosile kolonash  
vertebrale.

Shumë shkrime s'ja kishin botuar...  
Dhe ai lexonte revistave vargje të trishta, arkaike  
Si korridore të errëta, të ftohta kishe.

Shihte portretin e Duçes mbi mure dhe shtylla,  
Një karabinier që hynte të pinte në një kafe me  
armë në krah,  
Maqinat e rënda ushtarake qe ngjiteshin periferive  
të blerta  
Dhe e ndjente që diçka nga kombi i vet vdiste  
ngadalë.

Që malet dhe shtigjet e thella ku ngjiteshin maqinat  
ushtarake  
Peizazhet e lashta folkloristike ku flladiteshin  
muzgjeve këngë popullore  
Këngët e natyrshme popullore sa dhe një pemë, një  
ylber,  
Tani mund të dukeshin të lëvizshëm porsi dekore  
theatri).

Kortezhi perandorak afrohej ngadalë  
Milicët, bersalierët hidhnin lule...  
Tingujt e hymneve shkundeshtin mbi vetura si lule  
Dhe veturat duhet të shkelnin sa më shumë lule.



(Kjo ish e vetmja përfillje e tyre  
Dhe, po të përgjunjej një bersalier, apo çdo  
entuziast,  
Do të ishte mirë ta shkelnin si lulet).

Kortezhi perandorak afrohej ngadalë.  
(Për një çast një frikë dhe një ankth i tmerrshëm,  
Zhurma e turmës dallgëzoi larg  
Kortezhi afrohej, afrohej ngadalë  
Ai qëlloi. . .  
Lulet ju fishkën nga krismat e nxehta  
Zhurma e turmës sikur doli prej telave që fërgëlluan  
të nderë  
Kur qëlloi ju duk se rrëzoi nga muret një emblemë  
Se veturën e perandorit e ktheu në një katafalk të  
ftohtë, të rëndë  
Dhe tani para turmës mbeti i ngrirë si një mo-  
nument. . .)

S'e qëlloi dot perandorin  
Por diçka ju prish, diçka ju zhduk pritjes  
perandorake  
Diçka që s'shihej më  
As në veturat lluksoze,  
as në bajonetat e milicëve,  
as në puplat e bersa-  
lierëve.



## PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Fllad .....	3
Rruga e pyllit .....	5
Telat po kaptojnë kodra edhe male .....	7
Shkrimet e shokëve .....	9
Legjenda e përkrenares së Skënderbeut .....	10
Në studion e skulptorit .....	16
Në kinema .....	17
«Objekt turistik» .....	18
Rosat e egra .....	19
Dialog valleje .....	20
Piktori .....	22
Në Theth .....	23
Melodia e jetës .....	25
Ylberi .....	27
Vallja popullore .....	28
Diella .....	29
Një vajze .....	31
Hidrocentrali «Mao Ce Dun» .....	33
Kisha me dritë elektrike .....	35
O, portokalle, portokalle .....	43

Popullore .....	45
Shënime nga xhirimi i një filmi .....	46
Shote Galica .....	48
Në ballkonin e pritjes .....	51
Mbrëmë .....	53
Atentatori .....	54

LIBRI E SHËNIMEVE  
1971 1972

52180

Tirazhi 1500 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-65

---

Shtyp. NISh. Shtypshkronjave «MIHAL DURI»  
Stabilimenti «8 NENTORI» — Tiranë, 1970